ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-24-7669-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me inventar për zyrë dhe ordinanaca shëndetësore.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**WOOD CORPORATION L.L.C.**
NUI	**811289562**
Adresa	**Rr.Ukë Bytyqi**
Vendi	**Suharekë**
Kodi postar	**23000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Driton Gashi**
Adresa elektronike	**info@tenaseri.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**02.10.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me inventar për zyrë dhe ordinanaca shëndetësore.

Furnizim me inventar për zyrë dhe ordinanaca shëndetësore.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Nga dy oferta në procedurë, ne ishim ofertë me cmim më të lartë

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

AK ka refuzuar si kinse të pabazuar kërkesën për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7

Neni 59

Neni 61

Neni 70

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

HYRJE

1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit (tutje referuar si: "Autoriteti Kontraktues"), me datën 24.07.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar për zyrë dhe ordinanaca shëndetësore." Me numër të prokurimit: 622-24-7669-1-2-1.

2. Në këtë aktivitet të prokurimit, data e fundit për dorëzim të ofertave ishte 14.08.2024. Brenda afatit të përcaktuar Operatori ekonomik Wood Corporation LLC (tutje referuar si: "Parashtruesi i Ankesës") ka dorëzuar ofertë, në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë.

3. Me datë 14.08.2024 është bërë hapja e ofertave nga i cili proces kemi kuptuar se në këtë aktivitet të prokurimit, kemi aplikuar dy operator ekonomik. Me datën 17.09.2024 kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin kemi kuptuar se oferta jonë është vlerësuar si e pasuksesshme dhe se operator i rekomanduar për dhënie të kontratës është operatori ekonomik Mobelland ShPK (tutje referuar si "Operator i rekomanduar").

4. Nga qasja në dokumente zyrtare kemi kuptuar se operatori i rekomanduar ka ofertuar me çmime manipulative, duke kombinuar çmime abnormalisht të ulëta në shumicën e artikujve dhe çmime abnormalisht të larta në disa artikuj, ku pret që të ketë më shumë proposi. Gjithashtu, për një numër të pajisjeve të teknologjisë, nuk ka paraqitur dëshmi të prodhuesit nga i cili do t'i bëjë furnizimet, duke lënë të nënkuptohet se vet do të bëjë prodhimin e këtyre artikujve. Brenda afatit ligjor Parashtruesi i Ankesës ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, duke i adresuar të gjitha këto shkelje serioze të Ligjit të Prokurimit Publik.

5. Me datën 24.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Vendimin me anë të së cilit ka refuzuar si kinse të pabazuar kërkesën për rishqyrtim me anë të së cilës ka tentuar të përligj veprimet e paligjshme në fazën e vlerësimit të ofertave.

OFERTA E REKOMANDUAR ËSHTË OFERTË E PAPËRGJEGJSHME

6. Çmimet e ofruara nga Operatori i rekomanduar janë çmime abuzive, për shkak se në shumicën e pozicioneve ky Operator ka ofertuar me kosto nën vlerën reale në treg të produktit, madje me kosto të cilat nuk mbulojnë as shpenzimet e prodhimit dhe lëndës së parë. Tek pozicioni "Tavolina me dimensione 180cm x 70cm x 75cm me dollapa në njërin krah nga meteriali MDF" Operatori i rekomanduar ka ofertuar me vlerë prej 30 Euro për produkt.

7. Pastaj produktet e tjera pas saj me 29 dhe 28 Euro(shih pozicionet 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8,). Për pozicionin e TV 75 inch UHD 4K ka ofertuar 60 Euro. Për TV 50 inch, ka ofertuar në vlerë prej 50 Euro. Po ashtu për furnizim me frigorifer no frost me dimensione standarde ka ofertuar me vlerë 50 Euro (shih pozicionet 3.21, 3.22 dhe 3.23).

8. Në anën tjetër çmime jo normalisht të larta dhe abuzive ky operator ka ofertuar tek dy pozicione të perderve me 300 Euro për m2 dhe 400 Euro për copë (shih pozicionet 3.12 dhe 3.13). Në rastin përkatës Autoriteti Kontraktues, do të duhej që së pari të kërkoj sqarime për çmimet abnormalisht të ulëta dhe pastaj ta eliminoj ofertën si të papërgjegjshme. Në këto dy produkte, vlera e tregut është nën 30 euro dhe 8 Euro për atë që kishte aplikuar Operatori i rekomanduar me 400 Euro. Në fakt e gjithë oferta e këtij operatori është e plotësuar me çmime abnormalisht të ulëta duke tentuar që me disa pozicione specifike të manipulohet në atë mënyrë që të duket si ofertë më e lirë, por që në fund të rezultojë me fitim maksimal për operatorin.

9. Kjo çështje nga prokurimet paraprake të Autoritetit kontraktues, madje me të njëjtin operator ekonomik është çështje e gjykuar dhe e njohur si formë e manipulimit me oferta publike. Në fakt autoriteti kontraktues sipas vendimit të OSHP-së P.sh. Nr. 360/22 është ballafaquar me situatë pothuajse identike në vitin 2022. Në këtë rast OSHP ka gjetur se çmimet manipulative përbëjnë shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik. Autoriteti kontraktues është njoftuar për këtë fakt përmes kërkesës për rishqyrtim, mirëpo nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të parandaluar një gjë të tillë.

10. Tek Deklarata e Garancionit në dosje të tenderit është kërkuar si vijon: "Kërkesa 5.Garancioni për të gjithë inventarin të paktën 1 vit si dhe bartjen dhe montimin e inventarit në objektet shëndetësore sipas kërkesës së njësisë kërkuese-QKMF-së". Deklarata e ofruar nga ana e operatorit të rekomanduar nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që nuk përfshin garancionin për bartjen dhe montimin e inventarit.

11. Tek Certifikatat ISO dhe EN Operatori i rekomanduar, i ka ofruar certifikatat nga dy laboratorë të ndryshëm. Në rastin përkatës, asnjëri nga Laboratoret nuk ka ofruar asnjë informatë se janë të akredituar për të lëshuar këto certifikime. Për këtë arsye Autoriteti

kontraktues ka qenë dashur që të kërkoj sqarime direkt nga laboratorët nëse ata kanë akreditim apo jo për të lëshuar certifikatat e tilla. Tek Certifikata për EN 1090-1, laboratori nuk ka ofruar madje asnjë link apo QR kod ku mund të bëhet verifikimi i certifikatës. Në të dhënat nga qasja nuk kemi gjetur se është kërkuar informacion në lidhje me këtë çështje.

12. Katalogu i prodhuesit nuk është në përputhje me dosjen e tenderit, kjo pasi që aty, së pari operatori ka bërë copy paste specifikacionet teknike dhe së dyti nuk ka dhënë sqarime se cilët artikuj i prodhon vet, e cilët artikuj i blen nga një operator apo prodhues tjetër. Sipas informatave që kemi, në Kosovë nuk ka prodhues të televizioneve dhe frigoriferëve, bocave për shuarjen e zjarrit dhe të tjera.

13. Për më tepër, në ofertën e operatorit të rekomanduar ka munguar një kamion dhe lista e pajisjeve dhe dëshmitë nuk kanë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit. Në vend se të elimininohet si i papërgjegjshëm operatori, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar sqarime shtesë dhe e ka lejuar që përmes kërkesës për sqarime të shtoj/plotësoj në listë të pajisjeve edhe një kamion së bashku me dokumentacionin përcjellës. Një gjë e tillë nuk lejohet me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregulloren e KRPP për Prokurimin Publik. Po ashtu tek Aneksi 1 nuk është respektuar specifikacioni i detyrueshëm teknik pasi që operatori i rekomanduar ka dërguar një formë tjetër.

Duke marrë parasysh se oferta e rekomanduar është e papërgjegjshme, me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që të nxjerr këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik Wood Corporation LLC, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me inventar për zyrë dhe ordinanaca shëndetësore." Me numër të prokurimit: 622-24-7669-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kuvendi i Komunës së Prizrenit.

II. **ANULOHET**, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i Autoritetit Kontraktues i datës 17.09.2024 si dhe Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 24.09.2024 dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Në përputhje me Rregulloren e Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik Wood Corporation LLC, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N/a

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*